



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilbena / Prilbato Received / Delivered	08.11.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Iri Prot Ir Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/STK	6942/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1161/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1161/2023 të datës 15.09.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted], me adresë rruga "Vëllezërit Gërvalla", në Bregun e Diellit në Prishtinë, kundër Përgjigjes Nr.14-021/03-163747/23 të datës 17.08.2023 të Zyrës Ligjore të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1161/2023 e datës 15.09.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja fillimisht e punësuar sipas Akt Emërimit me numër 01-112-257 të datës 12.03.2013 në pozitën "Zyrtare e Lartë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural" në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Prishtinës, ndërsa pas Vendimit të datës 19.01.2016 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësit dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Publike, më datë 01.02.2017 i është lëshuar Akt Emërimi me numër 01 nr.112-257 për pozitën "Zyrtare për Blegtori, Bletari dhe Veterinari" në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, ndërsa ankimi ndaj këtij akti ka filluar me ankesë brenda Komunës së Prishtinës pastaj më datë 24.04.2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Sipas Vendimit A/02/339/2017 të datës 24.07.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është shfuqizuar Akt Emërimi 01 nr.112-257 i datës 01.02.2017, ndërsa është obliguar Kryetari i Komunës së Prishtinës që ankuesen ta sistemoj në një pozitë të Zyrtarit të Lartë, mirëpo pasi që nuk janë ndërmarr veprimet atëherë sipas Vendimit A/02/720/2017 të datës 12.12.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është obliguar Kryetari i Komunës së Prishtinës që të bëjë plotësim ndryshimin e akt emërimit të ankueses në pajtim me klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil dhe Rregullores për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësit dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Publike të Komunës së Prishtinës të datës 19.01.2016.

Ankuesja ka parashtruar kërkesë për përmbarimin e Vendimit A/02/339/2017 të datës 24.07.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila sipas Aktvendimit Cp.nr.14/18 të datës 17.07.2018 ka caktuar përmbarimin ndaj Komunës së Prishtinës duke e obliguar Komunën e Prishtinës që ankuesen ta sistemoj nga pozita "Zyrtare për Blektori, Bletari dhe Veterinari në sektorin për Bujqësi në drejtorinë e Bujqësisë në komunë të Prishtinës në pozitë të Zyrtarit të Lartë në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim, ndërsa bazuar në këtë aktvendim nga Gjykata Themelore në Prishtinë më datë 16.07.2019 është nxjerrë Urdhri për Përmbarim Cp.nr.14/2018.

Ankuesja më datë 09.08.2023 ka parashtruar kërkesë për kompensimin material sipas urdhrit të përmbarimit, ndërsa Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës përmes përgjigjes Nr.14-021/03-163747/23 të datës 17.08.2023, ka refuzuar kërkesën e ankueses.

Ankuesja më datë 15.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6088/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës. Ndërsa me datë 04.10.2023 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës duke plotësuar me prova shtesë më datë 26.10.2023.

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, më datë 30.10.2023 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr Vendim për zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankueses për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e kësaj ankesë duke vlerësuar relevancën e secilës prej tyre ka administruar këto prova: Ankesa me numër protokolli 6088/2023 të datës 15.09.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen Nr.14-021/03-163747/23 të datës 17.08.2023 të Zyrës Ligjore të Komunës së Prishtinës; kërkesën e datës 09.08.2023 të ankueses; Vendimin A/02/189/2017, Vendimin A/02/339/2017 dhe Vendimin

A/02/720/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin Cp.nr.14/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Urdhër për Përmbarrim i datës 16.07.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Akt Emërimit 01 nr.112-257 i datës 01.02.2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 04.10.2023; Akt Emërimit me Nr. 01-112-257 të datës 12.03.2013; Përkrahimin e detyrave të punës për pozitë Zyrtar për Blegtori, Bletari dhe Veterinari; Kërkesën për prova shtesë e datës 16.10.2023 dhe 18.10.2023; Përgjigjen e datës 26.10.2023 të Komunës së Prishtinës dhe Kartelën e nëpunësit prej vitit 2017 deri në vitin 2023; Vendimin e datës 30.10.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses, është e **pabazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar më datë 15.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komuna e Prishtinës nuk ka zbatuar urdhrin për përmbarrim të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke kërkuar kompensimin material në vlerën e një koeficienti nga data 01.02.2017 deri më datë 01.02.2023.

Lidhur me pretendimin e ankuesit Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 44 të Ligjit që ishte i aplikuar në këtë periudhë të ndryshimit të akt emërimit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku ishte përcaktuar se: *"Puna e nëpunësit civil kompensohet përmes sistemit të pagave, i cili rregullohet me ligj të veçantë"*, dispozitave të nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që ka qenë poashtu në fuqi në kohën kur ndërlihet periudha e kërkesës për kompensim më të cilin ishte përcaktuar se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, si dhe nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë që ishte në fuqi në këtë kohë e që ndërlihet e periudhën e kërkesës për kompensim poashtu, me të cilat dispozita parashihej se: *"1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...., dhe si rrjedhojë konstatoi se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë.*

Në kuptim të përcaktimit ligjorë si më lartë, Kolegji ka analizuar shkresat e lëndës nga konstatoi se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër 01-112-257 të datës 12.03.2013 ka qenë e emëruar në pozitën e punës me titull *"Zyrtare e Lartë"* në Sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Prishtinës. Duke u bazuar në Vendimin me numër protokollit 01 Nr.031-13761 të datës 19.01.2016 për organizmin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale, Kryetari i Komunës së Prishtinës ka nxjerrë Akt Emërim me numër protokollit 01-112-257 të datës 01.02.2017, me të cilin ankuesin e ka sistemuar në pozitën e punës *"Zyrtar për Blegtori, Bletari dhe Veterinari"* në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Prishtinës.



Andaj, Kolegji bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës konstatoi së janë të pabazuara pretendimet e ankueses që ti njihet e drejta e kompensimit të diferencës së koeficientit në mënyrë retroaktive nga data 01.02.2017 deri më datë 01.02.2023, sepse sipas Aktit të Emërimit me numër 01-112-257 të datës 12.03.2013 lidhur me pozitën "Zyrtare e Lartë" në Sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Prishtinës ankuesja ka realizuar koeficientin shtatë (7), dhe po ashtu bazuar në Akt Emërimin me numër protokolli 01-112-257 të datës 01.02.2017 dhe listës së pagës së muajit Janar 2023 ankuesja ka realizuar koeficient shtatë (7) të pagës për pozitën Zyrtar për Blegtori, Bletari dhe Veterinari në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Prishtinës, kështu që këtë e konfirmon edhe Komuna e Prishtinës përmes përgjigjes së datës 26.10.2023 e cila konfirmon se nga muaji Maj 2017 deri në Janar 2023 është paguar me koeficient shtatë (7), kurse kjo mund të konfirmohet edhe nga kartela e nëpunësit civil që ka të bëjë me pagat për këtë periudhë kohore, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, mbi bazën e këtyre fakteve konstaton se ankuesja nuk është dëmtuar në raport me të drejtën e pagës pasi që ka realizuar koeficient të njëjtë, përkundër ndryshimit të aktemrimit që është objekt i kësaj ankese.

Poashtu kolegji i këshillit me rastin e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë mori për bazë edhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë Cp.nr.14/18 të datës 17.07.2018 dhe Urdhri për Përmbarim Cp.nr.14/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 16.07.2019, me që rast vërtetohet se përmes këtyre dokumenteve gjyqësore është konfirmuar se kjo çështje tashmë ishte përmbyllur sa i përket ekzekutimit të vendimit të këshillit që ka qenë objekt në këtë procedurë përmbarimore-gjyqësore, dhe se nga vendimi i fundit-Urdhri për Përmbarim Cp.nr.14/18 i Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 16.07.2019, ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka ndër marrë veprimet adekuate konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore Nr.04/L-139, që në rast të mos përmbushjes së obligimeve në afate të caktuara sipas këtij Urdhri sipas kërkesës së kreditorit të zbatohen dispozitat e neneve 15 dhe 16 të LPP-së, andaj edhe veprimet e mëvonshme përkatësisht kërkesa e datës 09.08.2023 për realizim të një kërkesë të natyrës financiare duke filluar nga data 01.02.2017 është jashtë afateve ligjore që ndërlidhen me realizim të kërkesave të kësaj natyre.

Nga ajo që u tha si më lartë dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1161/2023, datë 08.11.2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së